

PROPOZIM PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2019

HYRJE

1. Rëndësia dhe qëllimet e subjektit

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor është i themeluar nga 9 njësi të vetëqeverisjes lokale të cilat bëjnë pjesë në rajonin planor Jugperëndimor. Qendra i kryen punët profesionale dhe tekniko-administrative për Këshillin për zhvillim dhe të cilat janë të një rëndësie të madhe për zhvillimin e rajonit planor Jugperëndimor, përkatësisht në drejtim të realizimit të qëllimeve dhe parimeve të politikave për zhvillim të barabartë rajonal.

Për realizimin e qëllimeve Qendra për zhvillim i kryen punët vijuese:

- Përgatit propozim-programin për zhvillim të rajonit planor në pajtueshmëri me metodologjinë e rregulluar me dispozitë ligjore
- Përgatit propozim-plan aksionar për implementimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor
- Përgatit propozim projekte rajonale për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor
- I koordinon aktivitetet në lidhje me implementimin e Programit për zhvillim dhe i realizon projektet rajonale për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor
- Siguron ndihmë profesionale dhe teknike për njësitë e vetëqeverisjes lokale gjatë përgatitjes së programeve dhe projekteve të tyre
- Siguron informacione dhe konsulta për shoqatat e qytetarëve dhe palë të tjera të interesuara gjatë përgatitjes së projekteve të tyre nga sfera e zhvillimit rajonal
- Nxit bashkëpunimin ndërkomunal, ndërrajonal dhe ndërkombëtar në kuadër të zhvillimit rajonal
- Zbaton projekte për nxitjen e zhvillimit rajonal që janë të financuara nga Unioni Evropian dhe burime të tjera ndërkombëtare
- Bën promovimin e mundësive zhvillimore të rajonit planor dhe të njësisve të vetëqeverisjes lokale të cilat janë në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor

2. Burimet e financimit

Buxheti i Republikës së Maqedonisë; Buxhetet e njësisve të vetëqeverisjes lokale; Fondet e Unionit Evropian; Burime tjera ndërkombëtare; Donacione dhe sponzorizime nga persona fizik dhe juridik; Mjete të tjera të parapara me ligj.

Përmes Programeve për ZHBR të MVL dhe BZHR për vitin 2019 në pajtim me buxhetin e projektuar, për rajonin planor Jugperëndimor janë paraparë rreth 31.000.000 DEN. Qendra aplikoi me propozim projekt tek Agjencia për mbështetje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural për Masën 321 nga Programi për zhvillim rural për vitin 2018. Qendra aplikoi me projekt tek Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ujërave përmes Programit për Investime Kapitale në rajonet planore për përmirësimin e qasjes deri te tokat bujqësore. Me Ministrinë e vetëqeverisjes lokale është nënshkruar Marrëveshje për mbështetje të Biznes Qendrës që do të mbështetet me 400.000 DEN nga buxheti qendror dhe 182.025 DEN nga Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC). Gjithashtu, është nënshkruar marrëveshje me MVL për kofinancim përmes projektit Zhvillim rajonal i qendrueshëm dhe inkluziv 2017-2020 në vlerë prej 754.868 DEN. Sipas paralajmërimeve SDC do të financojë projekt rajonal përmes Shemës së granteve, i cili do të përzgjidhet përmes forumeve rajonale. Të gjithë projektet e përmendura janë pjesë përbërëse e Planit financiar për vitin 2019.

3. Tabelat financiare

- Në Tabelën 1 janë paraqitur të hyrat e planifikuara për vitin 2019.
 - Në Tabelën 2 janë paraqitur shpenzimet e planifikuara për vitin 2019.
- Pas çdo table është dhënë përshkrimi i zërave bilancor në veçanti.

Tabela 1 pjesa e parë

TË HYRAT E PLANIFIKUARA 2019

TË HYRAT E PLANIFIKUARA 2019				Shuma në denarë	
Nr.ren.	Nr.llog.	Emri i llogarisë	PËRSHKRIMI	2018	2019
	74	Transferimet dhe donacionet			
1	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Vevqanit	135.228,00	152.769,00
2	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Dibrës	1.511.360,00	1.706.780,00
3	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Debërcës	165.210,00	165.210,00
4	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës	2.943.578,00	3.143.694,00
5	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Makedonski Brodit	678.395,00	709.405,00
6	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Ohrit	736.235,00	696.863,00
7	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Pllasnicës	431.775,00	477.225,00
8	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Strugës	3.468.800,00	1.801.280,00
9	741111	Transferime rrjedhëse nga nivele tjera të pushtetit	Transferimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së qendër Zhupës	130.380,00	130.380,00
10	741112	Transferimi nga Buxheti i RM	Transferimi i mjeteve nga MVL	2.400.000,00	2.400.000,00
		GJITHSEJ 1:		12.600.961,00	11.383.606,00

Tabela 1 pjesa e dytë

TË HYRAT E PLANIFIKUARA				Shuma në denarë	
Nr.ren.	Nr.llog.	Emri i llogarisë	PËRSHKRIMI	2018	2019
11	741114	Teprica e bartur e të hyrave nga viti i kaluar	Gjendja në 31.12	6.144.694,00	3.354.026,00
12	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Projekte rajonale 2018 – BZHR dhe MVL (PR ZHBR)	24.805.961,00	0
13	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Kontributi vetanak i komunave në projekte rajonale 2018	1.317.641,00	0
14	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Projekte rajonale 2019 – BZHR dhe MVL (PR ZHBR)	0	30.174.700,00
15	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Kontributi vetanak i komunave në projekte rajonale 2019*	0	1.508.735,00
16	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Projekte rajonale 2015- Programi për zhvillim rural - APBZHR	3.590.000,00	0
17	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Kontributi vetanak i komunave në projekte rajonale 2015 - PZHR	646.200,00	0
18	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Projekte rajonale 2018 - Programi për zhvillim rural - AMFBZHR	0	19.482.596,00
19	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Kontributi vetanak i komunave në projekte rajonale 2018 - PZHR*	0	3.506.867,00
20	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Kofinancimi për Projektin Biznes Qendra MVL	400.000,00	400.000,00
21	742119	Të hyra nga UNDP	Kofinancimi për Projektin Biznes Qendra	1.845.000,00	143.388,00
22	742119	Të hyra nga SDC	Kofinancimi për Projektin Biznes Qendra	0	182.025,00
23	742119	Të hyra nga SDC	Kofinancim përmes projektit ZHBR i qendrueshëm dhe inkluziv (2017-2020)	0	754.868,00
24	742119	Të hyra nga SDC	Shema e grandeve Projekt ZHBR i qendrueshëm dhe inkluziv (2017-2020)	0	6.025.533,00
25	741211	Transferime kapitale nga nivele tjera të pushtetit	Përmirësimi i qasjes deri te hapësirat e punëshme në RPJP (MBPU - Prog.Inv.Kap.)	0	9.849.717,00
			GJITHSEJ 2	37.256.551,00	75.239.067,00
			GJITHSEJ:	49.857.512,00	86.622.673,00

* Vërejtje - Këshillat e NJVL duhet që në Buxhetet komunale për vitin 2019 të miratojnë zëra bilancor për pjesëmarrje vetanake në projektet rajonale

Përshkrimi i zërave mbi të hyrat

Zërat nga numri rendor 1 deri te numri 9 – përfshin të hyrat në bazë të transferimeve të mjeteve nga buxhetet e të gjithë 9 komunave për punën vijuese të Qendrës për zhvillim në pajtim me nenet 24 dhe 26 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal, Vendimet për themelimin e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor të miratuara nga ana e Këshillave komunal dhe Marrëveshjeve për koofinancim të nënshkruar nga ana e të gjithë komunave në përbërje të rajonit dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale.

Zëri me numër rendor 10 – i përfshin të hyrat në bazë të transferimit të mjeteve nga Ministria e vetëqeverisjes lokale në pajtim me ndryshimet dhe plotësimet në nenin 25,26 dhe 34 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal dhe Marrëveshjes për koofinancim për vitin 2019 që do të nënshkruhet nga ana e të gjithë komunave në përbërje të rajonit dhe Ministrisë së vetëqeverisjes lokale.

Zëri me numër rendor 11 – i përfshin të hyrat në bazë të bartjes së mjeteve në pajtim me gjendjen e llogarisë duke përfshirë datën 31.12.2018.

Zëri me numër rendor 12 – mjete të fituara përmes programeve për ZHBR të MVL dhe BZHR për vitin 2018, për projekte rajonale për të cilat Qendra aplikoi deri te BZHR deri në datë 15 dhjetor 2017, dhe të njëjtat u implementuan gjatë vitit 2018.

Zëri me numër rendor 13 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve për kofinancim nga komunat në projektet rajonale për vitin 2018 (zëri me numër rendor 12).

Zëri me numër rendor 14 – i përfshin mjetet e parapara në programet për ZHBR të MVL dhe BZHR për vitin 2019 për projekte rajonale për të cilat QZHRPJ duhet të aplikojë deri te BZHR deri në 15 dhjetor të vitit 2018 dhe pas miratimit të implementohen në vitin 2019.

Zëri me numër rendor 15 – i përfshin të hyrat në bazë të kofinancimit të komunave (5% nga vlera e përgjithshme) në projektet rajonale për vitin 2019 nga zëri bilancor nr.14.

Zëri me numër rendor 16 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga Programi për zhvillim rural për vitin 2015 të fituara për projekt me të cilin Qendra aplikoi në vitin 2015 te Agjencia për përkrahje të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Zëri me numër rendor 17 – i përfshin të hyrat në bazë të koofinancimit vetanak të komunave partnerë në projekt nga numri rendor 16 (mjetet janë për TVSH).

Zëri me numër rendor 18 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga Programi për zhvillim rural për vitin 2018 për të cilat Qendra aplikoi në vitin 2018 në Agjencionin për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural (Masa 321).

Zëri me numër rendor 19 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve për pjesëmarrje vetanake të komunave partnere në projektin nga nr.18 (mjetet janë për TVSH).

Zëri me numër rendor 20 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga Programi për ZHBR të MVL për koofinancim të projektit Biznes Qendra.

Zëri me numër rendor 21 dhe 22 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga UNDP dhe SDC për kofinancim të projektit Biznes Qendra.

Zëri me numër rendor 23 dhe 24 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga SDC, për kofinancim të konferencës, katalogut, forumeve, dhe Shemës së Granteve përmes Projektit ZHBR i qendrueshëm dhe inkluziv 2017-2020.

Zëri me numër rendor 25 – i përfshin të hyrat në bazë të mjeteve nga Programi për investime kapitale në rajonet planore për vitin 2018 për të cilat qendra aplikoi tek MBPU.

Tabela 2 pjesa e parë

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA 2019

Nr.ren.	Konto	P Ë R S H K R I M I	Shuma në denarë
	40	Rrogat dhe kontributet	
1	401, 402	Bruto rrogat	3.000.000,00
2	404	Kontributet (regres pushim vjetor)	102.000,00
	41	Rezervat shpenzime të pa përcaktuara	
3	413	<i>Rezerva rrjedhëse (shpenzime të ndryshme)</i>	3.978.024,00
4	414	<i>Rezerva për shpenzime kapitale (projekte 2019 MVL/BZHR)</i>	31.683.435,00
	42	Stoqet dhe shërbimet	
5	4201	Shpenzime rruge dhe mëditje brenda shtetit	100.000,00
6	4202	Shpenzime rruge dhe mëditje jashtë shtetit	200.000,00
	421	<i>Shërbime komunale, nxeheje, komunikim, transport</i>	
7	4211	Shërbime komunale	100.000,00
8	4213	Shërbime komunikimi	460.000,00
9	4214	Shërbime transporti	630.000,00
	423	<i>Materiale dhe inventar i imët</i>	
10	4231	Punë administrative	185.000,00
11	4232	Materiale për AOP	60.000,00
12	4234	Produkte ushqimore dhe pije	150.000,00
13	4237	Materiale për riparim dhe mirëmbajtje	50.000,00
	424	<i>Riparime dhe mirëmbajtje vijuese</i>	
14	4241	Riparime dhe mirëmbajtje të veturave	100.000,00
15	4242	Riparime dhe mirëmbajtje të ndërtesave	100.000,00
16	4244	Riparime dhe mirëmbajtje të mobilieve dhe makinerive	50.000,00
	425	<i>Shërbime kontraktuese</i>	
17	4251	Huamarrja e sallave dhe pajisjeve	200.000,00
18	4252	Shërbime bankare dhe sigurime	80.000,00
19	4253	Shërbime gjyqësore dhe juridike	150.000,00
20	4254	Shërbime shëndetësore (kontroll vjetor i rregullt)	20.000,00
21	4259	Shërbime tjera kontraktuese	2.006.000,00
22	401320	Tatim personal nga shërbimet kontraktuese	36.220,00
23	4271	Punësime të përkohshme	432.000,00
	426	<i>Shpenzime tjera rrjedhëse</i>	
24	4261	Anëtarësime në organizata	200.000,00
25	4262	Shpenzime për reprezentacion	105.000,00
26	4263	Seminare dhe konferenca	200.000,00
27	4264	Shpallja e konkurseve	150.000,00
28	4269	Shpenzime tjera operative	100.000,00

Tabela 2 pjesa e dytë

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA 2019

Nr.ren.	Konto	PËRSHKRIMI	Shuma në denarë
	48	Shpenzime kapitale	
29	48	Projekte rajonale 2018 (Prog. Zhvillim rural Masa 321)	22.989.463,00
30	48	Projekt Biznes Qendra kofinancim MVL	400.000,00
31	48	Projekt Biznes Qendra kofinancim UNDP	143.388,00
32	48	Projekt Biznes Qendra kofinancim SDC	182.025,00
33	48	Kofinancim aktivitete SDC përmes projektit ZHBR i qendrueshëm dhe inkluziv 2017-2020	754.868,00
34	48	Shema e Granteve SDC Projekti ZHBR i qendrueshëm dhe inkluziv	6.025.533,00
35	48	Projekti Përmirësimi i qasjes deri te tokat bujqësore në RPJP - Prog. Investime Kapitale në RP - MBPU	9.849.717,00
	<i>480</i>	<i>Blerja e pajisjeve dhe makinerive</i>	
36	4801	Blerja e pajisjeve	300.000,00
37	4831	Mobilie	100.000,00
38	4852	Softuer kompjuterik	250.000,00
	<i>486</i>	<i>Blerja e automjetit</i>	
39	486110	Blerja e automjetit	1.000.000,00
		GJITHSEJ:	86.622.673,00

Përshkrimi i zërave të shpenzimeve

Zëri me numër rendor 2 – i përfshin shpenzimet në bazë të regresit për pushim vjetor për 6 të punësuar.

Zëri me numër rendor 4 – i përfshin shpenzimet në bazë të shpenzimeve kapitale nga mjetet e parapara për rajonin planor Jugperëndimor nga MVL dhe BZHR për projekte rajonale për vitin 2019 në pajtim me zërat bilancor të planifikuar për ZHBR në buxhetin nacional për vitin 2019, dhe kontributit vetanak i komunave.

Zëri me numër rendor 7 – i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve komunale – energji elektrike, ujësjellës dhe kanalizim, mbeturinat.

Zëri me numër rendor 8 – i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve për komunikim – telefon, internet, pajisje komunikuese, certifikate digjitale, përgatitja, hostimi dhe azhurnimi i UEB faqes.

Zëri me numër rendor 9 – i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve transportuese – gaz dhe vajra për Automobilin, regjistrimi i automobilit, transporti i mallrave, transporti i personave.

Zëri me numër rendor 10 – i përfshin shpenzimet me bazë për punë administrative – materiale zyre, shërbime për kopjim, botime, parapagimi i revistave, gazetave dhe botime tjera për shfrytëzim nga të punësuarit, materiale tjera administrative, shërbime nga Regjistri Qendror.

Zëri me numër rendor 11 – i përfshin shpenzimet me bazë materiale për AOP – tonerë për printerë dhe fotokopje, material i harxhuar për telefoni, materiali i harxhuar për lidhje kompjuterike dhe instalim, galanteri kompjuterike.

Zëri me numër rendor 12 – i përfshin shpenzimet në bazë të produkteve ushqimore dhe pije – pije për zyrë, pije për takimet me grupet e punës.

Zëri me numër rendor 14 – i përfshin shpenzimet në bazë të riparimit dhe mirëmbajtjes së veturave – pajisje dimri e detyrueshme për automobilin, servis i rregullt.

Zëri me numër rendor 15 - i përfshin shpenzimet në bazë të riparimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesës – materiale për mirëmbajtjen e higjienës, materiale për riparime të ndryshme, mirëmbajtja e hapësirave dhe pajisjeve.

Zëri me numër rendor 17 - i përfshin shpenzimet në bazë të huamarrjeve të hapësirave dhe pajisjeve – huamarrje e sallave me pajisje për takime, huamarrja e tendave për panaire.

Zëri me numër rendor 18 - i përfshin shpenzimet në bazë të shpenzimeve bankare dhe sigurimeve – provizione bankare, sigurimi i të punësuarve, sigurimi i patundshmërive dhe pajisjeve, sigurimi i automjeteve, sigurimi i hapësirave dhe pajisjeve.

Zëri me numër rendor 19 - i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve gjyqësore dhe juridike – shërbime juridike, përkthyes gjyqësor, ekspertiza dhe analiza gjyqësore.

Zëri me numër rendor 21 – i përfshin shpenzimet në bazë të shërbimeve tjera kontraktuese – përkthyes; shërbime për pastrim; kontabilitet; shërbime për botim dhe editim; shërbime konsulente; prezantimi në medime dhe marketing; revizione nga shtëpi të pavarura reviduese; shërbime tjera kontraktuese; mbikëqyrje mbi mirëmbajtje dhe ndërtim.

Zëri me numër rendor 23 – i përfshin shpenzimet në bazë të punësimeve të përkohëshme për projektet të financuara nga donatorë të jashtëm.

Zëri me numër rendor 26 – i përfshin shpenzimet për konferenca dhe seminare – pagesë për pjesëmarrje.

Zëri me numër rendor 29 – i përfshin shpenzimet në bazë të Projektit përmes Programit për zhvillim rural për vitin 2018 - Masa 321. Në të njëjtën konto është përfshirë edhe kontributi vetanak.

Zëri me numër rendor 30, 31 dhe 32 – i përfshin shpenzimet në bazë të implementimit të Projektit Biznes Qendra që financohet nga MVL, UNDP dhe SDC.

Zëri me numër rendor 33 – i përfshin shpenzimet në bazë të aktiviteteve të kofinancuara përmes Projektit “ZHBR i qendrueshëm dhe inkluziv 2017-2020” të SDC.

Zëri me numër rendor 34 – i përfshin shpenzimet në bazë të projektit përmes Shemës së Granteve nga Projekti “ZHBR i qendrueshëm dhe inkluziv 2017-2020” të SDC.

Zëri me numër rendor 35 – i përfshin shpenzimet në bazë të projektit (Përmirësimi i qasjes deri te tokat bujqësore në RPJP) përmes Programit për subvencione kapitale për zhvillim të rajoneve planore në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural për vitin 2018 të MBPU.

Zëri me numër rendor 36 - i përfshin shpenzimet në bazë të blerjes së pajisjeve – pajisje kompjuterike, pajisje zyre, pajisje informatike dhe video.

Zëri me numër rendor 38 - i përfshin shpenzimet në bazë të softuerit kompjuterik – softuer për menaxhment financiar, softuer për punën e arshivës, softuer për evidencë të projekteve dhe koordinim.

Shpërndarja e mjeteve të planifikuara në anën e të hyrave dhe të dalave në planin Financiar të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2019 është përgatitur në pajtim me Rregulloren për klasifikim të hyrave dhe Rregullores për klasifikim të shpenzimeve (Gaz. Zyrtare e RM nr. 76/2009), që zbatohet nga viti 2010. Duke e marrë parasysh llogarinë e thesarit të QZHRPJP me karakter qëllimor, Qendra nuk ka për detyrim që planin financiar ta dorëzojë tek zyrat e thesarit në Ohër.

Qendra për zhvillim të
rajonit planor Jugperëndimor

Udhëheqëse

Strugë
19.10.2018

m-r Mirjana Lozanoska